

# Programi i Transparencës

## I. HYRJE

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur programi i transparencës për Drejtorinë e Përgjithshme të Entit Kombëtar të Banesave. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimitarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” (LDI). Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Enti Kombëtar i Banesave (EKB) ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së. EKB-ja do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së. Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimitarisë së punës së Entit Kombëtar të Banesave, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare ekb.gov.al si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse, e cila prodhon ose administron dokumentin. Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë. Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e Entit Kombëtar të Banesave është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj. Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

## II. PARIME TË PËRGJITHSHME

Parimet kryesore, në të cilat mbështetet Programi i Transparencës së EKB-së janë:

1. “E drejta për informim” është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.
2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: EKB-ja ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjisllacionin në fuqi.
3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e EKB-së dhe përkatësisht: VKM nr.198 datë 04.05.1993 “Për krijimin e Entit Kombëtar të Banesave” i ndryshuar, Ligji nr.9232 datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, Akti Normativ nr.3 01.08.2012, “Për lirin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë banues në banesë ish pronë të subjekteve të shpronësuar”, Udhëzimi nr.6257 datë 02.09.2008 “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti” i ndryshuar, Udhëzimi nr.19 datë 13.09.2007 “Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme të zbatimit të programit të banesave me kosto të ulët”, Udhëzimi nr.17 datë 17.10.2012 “Për procedurat e shitjes së banesave pjesë përbërëse e objekteve në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Entin Kombëtar të Banesave, për qëllim privatizimi”, Urdhëri nr.125 datë 31.10.2012 “Marrjen e masave ligjore në EKB për zbatimin e aktit normativ nr.3 datë 01.08.2012 “Për lirin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesa ish pronë e subjekteve të shpronësuar”, Urdhëri nr.34 datë 23.12.2013 “Disa shtesa dhe ndryshime në Urdhërin nr.125 datë 31.10.2012”.
4. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.
5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” (këtë e tutje KDIMDP).
6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.
7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:
  - i plotë;
  - i saktë;
  - i përditësuar;
  - i thjeshtë në konsultim;
  - i kuptueshëm;
  - lehtësisht i aksesueshëm;
  - i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

## III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, Enti Kombëtar i Banesave vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit ekb.gov.al dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- ♣ Strukturën organizative, funksionet, detyrat dhe strukturën e pagave të Entit Kombëtar të Banesave;
- ♣ Tekstet e plota të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të EKB-së dhe që prek publikun e gjerë;
- ♣ Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- ♣ Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të Entit Kombëtar të Banesave, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e Drejtorit të Përgjithshëm, Zv.Drejtorit të Përgjithshëm, koordinatorit për të drejtën e informimit, si dhe adresa zyrtare e e-mail të institucionit;
- ♣ Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e Drejtorit të Përgjithshëm të EKB-së, Zv.Drejtorit të Përgjithshëm si dhe Drejtorëve të Drejtorive Rajonale, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të përzgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik;
- ♣ Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi Entin Kombëtar të Banesave, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit nga Audit i Ministrisë së Zhvillimit Urban si dhe Audit i Brendshëm i EKB-së;
- ♣ Programi ekonomik vjetor i Entit Kombëtar të Banesave si dhe raporti ekonomik mbi të ardhurat, shpenzimet dhe investimet për një afat kohor 3-mujor;
- ♣ Rregjistri i Prokurimeve Publike vjetor i Entit Kombëtar të Banesave, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik;
- ♣ Informacion për shërbimet që Enti Kombëtar i Banesave i jep publikut, duke përfshirë aktet ligjore dhe nënligjore që përcaktojnë procedurat për kryerjen e këtyre shërbimeve: “Akti Normativ nr.3 “Për lirin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish pronë e subjekteve të shpronësuara”, Kredia me interes 0% për të pastrehët në ish-pronë private, Udhëzimi nr.6257 “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti” i ndryshuar, VKM-të e nxjerra nga qeveria për kalimin e objekteve të ndryshme EKB-së me qëllim privatizimin;
- ♣ Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e Entit Kombëtar të Banesave, nëpërmjet ndjekjes së rrugës administrative Drejtori i Përgjithshëm i EKB-së, Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe organeve gjyqësore;
- ♣ Enti Kombëtar i Banesave, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje dixhitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë;
- ♣ Akti administrativ i nxjerrë nga EKB (Njoftim Konfirmim), pas daljes së Urdhër Ekzekutimit nga Gjykatat respektive për këtë akt që e kthen atë në një titull ekzekutiv, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga AP-ja. Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.

#### IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENÇES SË ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE

Kategoritë e informacionit publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti/Përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të Entit Kombëtar të Banesave	Neni 7/1/a/d	Vendim miratimi i Këshillit Drejtues të EKB-së/Skema  Struktura e pagave  Organigrama e  Entit Kombëtar të Banesave	Pas miratimit të vendimit të Këshillit Drejtues/Përditësohet pas çdo akt emërimi  Menjëherë pas miratimit të Programit të Transparencës	Në faqen zyrtare në rubrikën <i>EKB</i> .	Drejtoria Juridike, Drejtoria Ekonomike Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Koordinatori i Informacionit
Akte ligjore;akte nën ligjore;  rregullore;  dokument tjetër.	Neni 7/1/b	Ligje/Akte Nënligjore  Rregullore  Kod Sjellje	Pas miratimit në Fletoren Zyrtare/Pas miratimit të urdhrat nga Drejtori i Përgjithshëm	Në faqen zyrtare në nënkategori <i>Legjislacioni</i> ,rubrika <i>EKB</i>	Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, Koordinatori i Informacionit
Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për	Neni 7/1/c/g	ShpjegueseAdresa Postare dhe Adresa e	Pas miratimit të Programit të transparencës.Menjëherë në	Në faqen zyrtare në rubrikën <i>Kontakte</i>	Drejtoria e Shërbimeve

informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.		e-mail <a href="mailto:info@ekb.gov.al">info@ekb.gov.al</a>	rast ndryshimesh		Mbështetëse dhe Koordinator i Informacionit
Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.	Neni 7/1ç	Shpjeguese Adresa e institucionit dhe e-mail e kontakteve për qytetarët	Pas miratimit të urdhrin të Drejtorit të Përgjithshëm	Në faqen zyrtare në rubrikën <i>Kontakte</i>	Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe Koordinator i Informacionit
Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe kompetencat e funksionarëve të lartë Struktura e pagave për nëpunësit dhe funksionarët e lartë	Neni 7/1d	Vendim i Këshillit Drejtues të EKB-së Vendim miratimi	Pas miratimit të Vendimit të Këshillit Drejtues Përditësohet pas çdo akt emërimi	Në faqen zyrtare në nënkategori <i>Drejtori i EKB</i> Pas miratimit të Programit të Transparencës	Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse dhe Koordinator i Informacionit
Mekanizmat monitorues; raporte audit; dokumentet me tregues performance	Neni 7/1dh	Raporte Auditit të <i>Auditit të Brendshëm të EKB-së, Auditit të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Këshillit të Lartë të Shtetit</i>	Pas miratimit të Programit të Transparencës	Në faqen zyrtare në kategorinë <i>EKB</i>	Drejtoria e Auditit dhe Koordinator i Informacionit
Programi ekonomik vjetor i Entit Kombëtar të Banesave Raporti për programin e të ardhurave, shpenzimeve dhe investimeve të EKB-së çdo 3 muaj	Neni 7/1e	Raporti vjetor ekonomik i Entit Kombëtar të Banesave	Pas vendimit të miratimit nga Këshilli Drejtues i EKB-së Pas miratimit të Programit të Transparencës	Në faqen zyrtare në kategorinë <i>EKB</i>	Drejtoria Ekonomike
Regjistri vjetor i Prokurimeve të EKB-së	Neni 7/1ë	Regjistri	Menjherë pas dërgimit në APP Pas miratimit të Programit të Transparencës	Në faqen zyrtare në kategorinë <i>Prokurime</i>	Drejtoria e Prokurimeve
Shërbimet e EKB-së për publikun: Akti normative nr.3, Kredia me 0% interes për të pastrehët, Udhëzimi nr.6257 për kredi të lehtësuara nga shteti, VKM të ndryshme për kalim objektsh EKB-së me qëllim privatizimin	Neni 7/1f	Akte ligjore dhe akte nënligjore	Pas publikimit në Fletoren zyrtare Vendimi i Komisionit për kreditë me 0% interes	Në faqen zyrtare në kategorinë <i>Për qytetarët</i>	Drejtoria Juridike, Drejtoria Ekonomike Drejtoria Teknike
Program i banesave me kosto të ulët Projekte të Entit Kombëtar të Banesave për banesa me kosto të ulët	Neni 7/1f	Ligji nr.9232 datë 13.05.2004, Pika 1 e VKM nr.198 datë 04.05.1993	Pas miratimit në Fletoren Zyrtare	Në faqen zyrtare në rubrikën <i>Projekte, Banesa në Shitje dhe Kosto e ndërtimit</i>	Drejtoria Juridike dhe Drejtoria Teknike
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji nr.119/2014.	Neni 7/1i	Tabelë	Pas miratimit të Programit të Transparencës	Në faqen zyrtare në rubrikën <i>“Programi i Transparencës”</i>	Koordinatori i Informacionit
Njoftimet e përditësuara të aktiviteteve të Entit Kombëtar të Banesave	Neni 7/1j	Njoftimet	Pas realizimit të aktiviteteve	Në faqen zyrtare në rubrikën <i>Njoftime për Shtyp</i>	Koordinatori i Informacionit

## V. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, EKB-ja vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit [ekb.gov.al](http://ekb.gov.al) dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës”.

## VI. MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit. Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.